FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 6

Tiranë – E premte, 25 janar 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 21/2019, datë 21.1.2019	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 86/2017 "Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit".....	181
Vendim i Kuvendit nr. 22/2019, datë 21.1.2019	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017 "Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit", të ndryshuar...	181
Vendim i Kuvendit nr. 23/2019, datë 21.1.2019	Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së komisionit të posaçëm parlamentar për realizimin e reformës zgjedhore.....	182
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 23.1.2019	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për marrëdhëniet me Parlamentin.....	182
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 23.1.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr.654, datë 14.9.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara", të ndryshuar.....	184
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 29, datë 23.1.2019	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së El Salvadorit, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, zyrtare, të shërbimit dhe të zakonshme.....	190
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 30, datë 23.1.2019	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Asfaltim i rrugës 'Kodërmalekaj', Bashkia Lezhë".....	195
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 23.1.2019	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikim i qendrës së qytetit Çorovodë", faza e dytë, bashkia Skrapar.....	197
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 32, datë 23.1.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1299, datë 16.12.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të punonjësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna dhe në degët e qarqeve", të ndryshuar.....	198

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 33, datë 23.1.2019	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Ndërtimi i një qendre multifunksionale për fëmijët me aftësi të kufizuara", në fshatin Poshnje, bashkia Ura Vajgurore.....	198
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 34, datë 23.1.2019	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Rikualifikim urban i sheshit në fshatin Samaticë", Ura Vajgurore.....	199
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 35, datë 23.1.2019	Për miratimin e buxhetit të vitit 2019 për Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.....	200
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 36, datë 23.1.2019	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin, nxitjen e biznesit dhe informimin e diasporës.....	215
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 37, datë 23.1.2019	Për emërim në detyrë.....	216
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 38, datë 23.1.2019	Për lirim nga detyra.....	216
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 14, datë 22.01.2019	Mbi fillimin e procesit të krijimit të skemës së delegimit.....	217

VENDIM
Nr. 21/2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 86/2017 "PËR CAKTIMIN E KRYESIVE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT"

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në pikën I të vendimit të Kuvendit nr. 86/2017, "Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit", bëhen këto ndryshime:

I. Deputeti Arben Ahmetaj (PS) caktohet Kryetar në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

II. Deputetja Senida Mesi (PS) caktohet Zëvendëskryetare në Komisionin për Integrimin Europian.

III. Deputeti Niko Peleshi (PS) caktohet Kryetar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

IV. Deputetja Klodiana Spahiu (PS) caktohet Zëvendëskryetare në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

V. Deputeti Arben Kamami (PS) caktohet sekretar në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 21.1.2019.

VENDIM
Nr. 22/2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 90/2017 "PËR CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të neneve 21, pika 2, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017, "Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

I. Deputeti Damian Gjiknuri caktohet anëtar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Deputeti Arben Pëllumbi largohet nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat dhe caktohet anëtar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

III. Deputetja Mirela Kumbaro caktohet anëtare në Komisionin për Integrimin Europian dhe në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

IV. Deputetët Senida Mesi dhe Vullnet Sinaj caktohen anëtarë në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

V. Deputetët Alket Hyseni, Ditmir Bushati dhe Reme Lala caktohen anëtarë në Komisionin për Politikën e Jashtme.

VI. Deputetja Lindita Nikolla caktohet anëtare në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe deputeti Fatmir Velaj largohet nga ky komision.

VII. Deputetet Antoneta Dhima dhe Elena Xhina caktohen anëtare në Komisionin për Sigurinë Kombëtare dhe deputeti Vullnet Sinaj largohet nga ky komision.

VIII. Deputetja Klotilda Bushka largohet nga Komisioni për Politikën e Jashtme dhe caktohet anëtare në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 21.1.2019.

VENDIM
Nr. 23/2019

PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR REALIZIMIN E REFORMËS ZGJEDHORE

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore zgjatet për një periudhë 1-mujore nga data e miratimit të këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 21.1.2019.

VENDIM
Nr. 27, datë 23.1.2019

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRIT TË SHTETIT PËR MARRËDHËNIET ME PARLAMENTIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Miratimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, si dhe të kompetencave për realizimin e tyre, sipas këtij vendimi.

II. Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin e ushtron veprimtarinë e tij në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

1. Në cilësinë e përfaqësuesit të Këshillit të Ministrave, ndjek dhe bashkërendon veprimtarinë e qeverisë me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë (në vijim, Kuvendi), për:

a) hartimin dhe miratimin e programit të punës e të kalendarit të punimeve të Kuvendit;

b) procesin e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave, si dhe dërgimin e të dhënave apo të informacioneve gjatë procesit ligjbërës të Kuvendit;

c) seancat e pyetjeve, interpelancat, peticionet, si dhe kontrollin që ushtrojnë komisionet e përhershme parlamentare mbi ministritë përgjegjëse apo autoritetet përgjegjëse të administratës shtetërore.

2. Përgatit dokumente apo mendime vlerësuese për projektaktet e propozuara për shqyrtim në Këshillin e Ministrave. Bashkërendon, nëse nevojitet, veprimtarinë e Këshillit të Ministrave, ministrive apo autoriteteve përgjegjëse shtetërore me institucionet e pavarura.

3. Përfaqëson Këshillin e Ministrave në marrëdhëniet e informimit të publikut për vendimmarrjet e Këshillit të Ministrave.

III. Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, për realizimin e fushës së përgjegjësisë, sipas pikës 1, të ndarjes II, të këtij vendimi, ka këto kompetenca:

1. Merr pjesë në mbledhjen e konferencës së kryetarëve të Kuvendit.

2. Bashkërendon programin dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit me programin politik të Këshillit të Ministrave.

3. Informon vazhdimisht dhe në kohë Kryeministrin, kur është rasti, edhe Këshillin e Ministrave, për programin dhe kalendarin e procesit ligjbërës të Kuvendit, si dhe për aktivitetet

e tjera të tij.

4. Ndjek në mënyrë periodike ecurinë e procesit ligjbërës në Kuvend, nëpërmjet procesverbaleve dhe relacioneve që përpunohen gjatë shqyrtimit të projektligjeve dhe informon Kryeministrin për problematikat që mund të dalin gjatë këtij procesi.

5. Bashkërendon punën për pjesëmarrjen e anëtarëve të Këshillit të Ministrave në mbledhjet e komisioneve të Kuvendit.

6. Kujdeset për dërgimin në komisionet e Kuvendit të relacioneve, të të dhënave apo dhe të informacioneve të kërkuara nga ministritë apo autoritetet përgjegjëse shtetërore gjatë procesit të:

a) shqyrtimit të një projektligji;

b) zhvillimit të një procedure pyetjesh, interpelance apo shqyrtimi të një peticioni.

7. Ndjek ecurinë në Kuvend të projektligjeve të ndërmarra me nismën e një deputeti apo njëzet mijë zgjedhësve:

a) duke bashkërenduar punën dhe duke u kujdesur për dërgimin pranë komisionit përkatës të Kuvendit të mendimeve nga ministria, në fushën e përgjegjësisë të së cilës është projektligji;

b) duke vlerësuar nëse përmbajtja e tyre harmonizohet me programin politik të Këshillit të Ministrave;

c) duke bashkërenduar punën me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për analizën për koston financiare që ka projektligji për buxhetin e shtetit, nëse do të ketë një efekt të tillë.

8. Njofton Kryeministrin për problematikat e konstatuara gjatë shqyrtimit në Kuvend të projektligjeve të ndërmarra me nismën e një deputeti apo njëzet mijë zgjedhësve.

9. Përfaqëson Këshillin e Ministrave në mbledhjet e komisioneve të Kuvendit, ku shqyrtohen projektligje apo akte normative të ndërmarra me nismën e Kryeministrit.

10. Ndjek, së bashku me drejtuesit e institucioneve të pavarura, shqyrtimin në Kuvend të projektligjeve, që trajtojnë organizimin dhe funksionimin e këtyre institucioneve.

11. Kujdeset dhe bashkërendon procesin e një kontrolli parlamentar të ndërmarrë nga komisionet e Kuvendit me ministrinë apo autoritetin përgjegjës të administratës shtetërore, i cili është subjekt i kontrollit.

12. Bashkërendon punën dhe bashkëpunon me kryetarët e grupeve parlamentare për ecurinë e procesit ligjbërës.

13. Bashkërendon punën me kryetarin e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare për hartimin e kalendarit të seancave për pyetje, interpelanca, mocione të besimit apo mosbesimit.

14. Përfaqëson Këshillin e Ministrave në institucionet e ndryshme për paraqitjen e programit e të kalendarit të punimeve të Kuvendit, si dhe të përparësive të politikave të qeverisë.

15. Kujdeset për kryerjen e detyrave për përcjelljen në Kuvend të projektakteve normative.

16. Kujdeset dhe ndjek procedurat për shqyrtimin dhe miratimin në Kuvend të emërimeve që paraqiten me propozimin e Këshillit të Ministrave apo të ministrave përgjegjës.

IV. Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, për realizimin e fushës së përgjegjësisë, sipas pikës 2, të ndarjes II, të këtij vendimi, ka këto kompetenca:

1. Përgatit bashkërisht me ministritë e interesuara dhe paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave mendimin me shkrim për projektligjet e ndërmarra me nismën e një deputeti apo njëzet mijë zgjedhësve.

2. Nëse e vlerëson të nevojshme, jep mendim me shkrim për projektakte të veçanta, gjatë fazës së bashkërendimit të tyre, për përputhshmërinë e tyre me:

a) Kushtetutën, ligjet në fuqi dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;

b) programin politik të Këshillit të Ministrave;

c) kërkesat apo opinionet e dokumenteve politike dhe të raporteve të institucioneve të Bashkimit Evropian, në kuadër të procesit të integrimit evropian.

3. Paraqet në Këshillin e Ministrave analiza, raporte, vlerësime apo rekomandime, të përgatitura nga grupe pune të ngritura me urdhër të Kryeministrit, në lidhje me zbatueshmërinë e normave juridike të caktuara apo për projektakte, të cilat synojnë zbatimin e reformave të rëndësishme, sipas programit të qeverisë.

4. Drejton ose bashkërendon veprimtarinë e grupeve ndërministrore apo ndërinstitucionale të punës për përgatitjen apo vlerësimin e projektakteve, sa herë që kjo i caktohet me urdhër të Kryeministrit.

5. Realizon, kur është e nevojshme, konsultime me grupe interesi, shoqërinë civile

dhe/ose përfaqësues të ministrive, institucioneve të pavarura apo autoriteteve shtetërore përgjegjëse për projektligje të ndryshme dhe informon Këshillin e Ministrave në lidhje me këto konsultime.

6. Bashkërendon punën dhe trajton shqetësimet që kanë institucionet e pavarura apo institucione të tjera, në lidhje me:

a) marrëdhëniet institucionale që ato kanë me Këshillin e Ministrave, ministritë apo autoritete të ndryshme shtetërore përgjegjëse;

b) hartimin e projektakteve që trajtojnë organizimin dhe funksionimin e tyre;

c) interesa të tjerë që ato kanë për projektakte të ndryshme apo për procesin ligjbërës.

7. Kujdeset për dërgimin në Kuvend të përgjigjeve të përgatitura nga ministritë apo autoritetet shtetërore përgjegjëse për kërkesat për të dhëna dhe informacione gjatë procesit të shqyrtimit të një projektligji apo gjatë një procedure parlamentare pyetjesh apo peticioni.

8. Kujdeset për respektimin e procedurave dhe të afateve ligjore për emërimet që i propozohen Kuvendit nga Këshilli i Ministrave apo ministri përgjegjës.

9. Promovon, në cilësinë e përfaqësuesit të Këshillit të Ministrave, realizimin e objektivave parësorë të qeverisë.

V. Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, për realizimin e fushës së përgjegjësisë, sipas pikës 3, të ndarjes II, të këtij vendimi, ushtron kompetencat e zëdhënësit të Këshillit të Ministrave për informimin e vendimmarrjeve më të rëndësishme të tij, si dhe për ato me interes për publikun.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 28, datë 23.1.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.654, DATË 14.9.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr.13/2016, "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.654, datë 14.9.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Shtojca I, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Shtojca II, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Numri i punonjësve të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) të jetë, gjithsej, 155 veta.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama


ADISA
VËMENDJA JONË. TI
KËSHILLI DREJTUES
DREJTORI EKZEKUTIV
SEKTORI I AUDITIT (1+2)
SEKTORI I KERKIMIT DHE INOVACIONIT Adisa LAB (1 + 2)
SEKRETAR
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE QENDRAVE (1 + 11)
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE BRENDSHEM (1+14)
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TE SHERBIMEVE (1+12)
DREJTORIA EKONOMIKE (1+9)
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TE PROJEKTEVE 1+2
SEKTORI I MBIKQYRJES SE LEVRIMIT TE SHERBIMEVE 1+3
SEKTORI I KOMUNIKIMIT ME QYTETARIN 1+3
SEKTORI JURIDIK 1+2
SEKTORI I SHERBIMEVE MBESHTETESE 1+3
SEKTORI I BURIMEVE NJEREZORE DHE PROTOKOLLIT 1+3
SEKTORI I TRAJNIMEVE DHE MENAXHIMIT TE NJOHURIVE 1+2
SEKTORI I RI-INXHINIERIMIT DHE MARREDHENIEVE INSTITUCIONALE 1+3
SEKTORI I ZHVILLIMIT TË STANDARTEVE 1+2
SEKTORI I PERFORMANCËS DHE STATISTIKAVE 1+4
SEKTORI I FINANCES 1+2
SEKTORI I INVESTIMEVE 1+2
SEKTORI I PROKURIMEVE 1+2
ZYRA RAJONALE TIRANE 1+32
ZYRA VENDORE KAVAJE 1+10
ZYRA RAJONALE FIER 1+15
ZYRA VENDORE KRUJE 1+8
ZYRA RAJONALE GJIROKASTER 1+12
ZYRA RAJONALE SHKODER 1+12
ZYRA VENDORE MALIQ 1+1

ORAGNIKA E AGJENCISE SE OFRIMIT TE SHERBIMEVE PUBLIKE TE INTEGRUARA

		KATEGORIA	POZICIONI
I.	**DREJTOR EKZEKUTIV (TITULLAR I INSTITUCIONIT)**	**II- a**	**1**
	SEKRETAR	VIII	1
	SEKTORI I AUDITIT		(3)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
	SEKTORI I KERKIMIT DHE INOVACIONIT/ADISA LAB		**(3)**
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
II.	**DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË QENDRAVE**		**(12)**
	DREJTOR	II-b	1
	SEKTORI I PLANIFIMIKIMIT DHE MENAXHIMIT TE PROJEKTEVE		**(3)**
	PERGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
	SEKTORI I KOMUNIKIMIT ME QYTETARIN		**(4)**
	PERGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	3
	SEKTORI I MBIKQYRJES SE LEVRIMIT TE SHERBIMEVE		**(4)**
	PERGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	3

I.	**DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE BRENDSHEM**		**(15)**
	DREJTOR	II-b	1
	SEKTORI JURIDIK		**(3)**
	PERGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
	SEKTORI I SHERBIMEVE MBESHTETESE		**(4)**
	PERGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	1
	PUNONJESE PASTRIMI	I	1
	MAGAZINIER/MIREMBATJE	VI	1
	SEKTORI I BURIMEVE NJEREZORE DHE PROTOKOLLIT		**(4)**
	PERGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
	SPECIALIST ARKIV-PROTOKOLL	IV-b	1
	SEKTORI I TRAJNIMEVE DHE MENAXHIMIT TE NJOHURIVE		**(3)**
	PERGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
II.	**DREJTORIA E ZHVILLIMIT TE SHERBIMEVE**		**(13)**
	DREJTOR	II-b	1
	SEKTORI I RI-INXHINIERIMIT DHE MARREDHENIEVE INSTITUCIONALE		**(4)**
	PERGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	3

	SEKTORI I ZHVILLIMIT TË STANDARTEVE		**(3)**
	PERGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
	SEKTORI I PERFORMANCËS DHE STATISTIKAVE		**(5)**
	PERGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	4
I.	**DREJTORIA EKONOMIKE**		**(10)**
	DREJTOR	II-b	1
	SEKTORI I FINANCËS		(3)
	PERGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
	SEKTORI I INVESTIMEVE		(3)
	PERGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
	SEKTORI I PROKURIMEVE		(3)
	PERGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
II.	**ZYRA RAJONALE/VENDORE**		**(97)**
	ZYRA RAJONALE TIRANE		**(33)**
	PERGJEGJES ZYRE	III-b	1
	SPECIALIST	IV-b	28
	PUNONJËS PASTRIMI	I	2
	SHOFER	IV	1
	MIRËMBAJTES	IV	1
	ZYRA E VENDORE KAVAJE		**(11)**

PERGJEGJES ZYRE	IV-a	1
SPECIALIST	IV-c	9
PUNONJËS PASTRIMI	I	1
ZYRA RAJONALE FIER		**(16)**
PERGJEGJES ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	13
PUNONJËS PASTRIMI	I	1
SHOFER	IV	1
ZYRA VENDORE KRUJE		**(9)**
PERGJEGJES ZYRE	IV-a	1
SPECIALIST	IV-c	7
PUNONJËS PASTRIMI	I	1
ZYRA RAJONALE GJIROKASTËR		**(13)**
PERGJEGJES ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	10
PUNONJËS PASTRIMI	I	1
MIRËMBAJTES	IV	1
ZYRA RAJONALE SHKODËR		**(13)**
PERGJEGJES ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	10
PUNONJËS PASTRIMI	I	1
SHOFER	IV	1
ZYRA VENDORE MALIQ		**(2)**
PERGJEGJES ZYRE	IV-a	1
SPECIALIST	IV-c	1

VENDIM
Nr. 29, datë 23.1.2019

Për MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË EL SALVADORIT, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, ZYRTARE, TË SHËRBIMIT DHE TË ZAKONSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së El Salvadorit, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, zyrtare, të shërbimit dhe të zakonshme, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISE SË REPUBLIKËS SË SALVADORIT MBI HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, ZYRTARE, TË SHËRBIMIT DHE TË ZAKONSHME

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Salvadorit, këtej e tutje në mënyrë individuale të referuara si "Palë" dhe kolektivisht si "Palët";

duke njohur ekzistencën e marrëdhënieve miqësore mes të dy vendeve;

me dëshirën për të lehtësuar procedurat që lidhen me vizitat e shtetasve të dy vendeve, mbajtës të pasaportave diplomatike apo të shërbimit dhe/ose zyrtare apo të zakonshme, Republika e Shqipërisë dhe Republika e Salvadorit;

në përputhje me ligjet dhe rregulloret e vendeve përkatëse,

kanë rënë dakord sa më poshtë vijon:

Neni 1
Heqja e vizave

Shtetasit e të dy Palëve, të cilët janë mbajtës të pasaportave diplomatike, zyrtare dhe të shërbimit përjashtohen nga marrja e një vizë hyrje, qëndrimi dhe largimi nga territori i Palës tjetër, për një periudhë që nuk duhet të kalojë 90 (nëntëdhjetë) ditë brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes, të rinovueshme, në përputhje me ligjet përkatëse, të cilët nuk mund të angazhohen në ndonjë aktivitet pune në territorin e Palës tjetër pa autorizimin paraprak nga autoritetet kompetente.

Shtetasit e të dy Palëve, të cilët janë mbajtës të pasaportave të zakonshme përjashtohen nga marrja e një vizë hyrje, qëndrimi dhe largimi nga territori e të dyja palëve, për një periudhë që nuk duhet të kalojë 30 (tridhjetë) ditë brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes, të rinovueshme, në përputhje me ligjet përkatëse, të cilët nuk mund të angazhohen në ndonjë aktivitet pune në territorin e Palës tjetër pa autorizimin paraprak nga autoritetet kompetente.

Neni 2
Kohëzgjatja e vlefshmërisë së pasaportës

Pasaportat e shtetasve të secilës Palë duhet të kenë së paku 6 muaj vlefshmëri, në mënyrë që të përdoren për të hyrë në territorin e Palës tjetër.

Neni 3
Vende të kontrollit të hyrjes

Shtetasit e secilës Palë, mbajtës të pasaportave diplomatike ose të shërbimit dhe/ose zyrtare apo të zakonshme, mund të hyjnë, qëndrojnë apo të largohen nga territori i Palës tjetër përmes çdo kufiri tokësor, ajror dhe detar të mundësuar, me kusht që ata të jenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e palëve respektive në lidhje me hyrjen dhe qëndrimin e të huajve.

Neni 4
Kufizimi i vizës

Mbajtësit e pasaportave të vlefshme të secilës Palë të përmendura në këtë Marrëveshje mund të hyjnë dhe largohen nga territori i Palës tjetër nga çdo kufi i autorizuar për këtë qëllim nga autoritetet kompetente të emigracionit, pa asnjë kufizim, përveç atyre të parashikuara për arsye sigurie, kontrollin e emigracionit, doganave, sanitar dhe të dispozitave të tjera në fuqi.

Neni 5
E drejta për mospranim/refuzim

Secila Palë rezervon të drejtën e refuzimit të hyrjes, shkurtimit ose përfundimit të kohëzgjatjes së qëndrimit të shtetasve të Palës tjetër që gëzojnë të drejtën për përjashtimin dhe lehtësimin e vizave në bazë të kësaj Marrëveshjeje, nëse vlerëson personin si të padëshirueshëm.

Neni 6
Modele për pasaportë

Palët shkëmbejnë, nëpërmjet kanaleve diplomatike, mostra të pasaportave të tyre që përdoren nga secila palë tridhjetë (30) ditë para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, si dhe mostra të pasaportave të reja para futjes së tyre.

Neni 7
Pezullimi

Secila Palë mundet në çdo kohë të pezullojë përkohësisht zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, tërësisht ose pjesërisht, për arsye të sigurisë kombëtare, rendit publik apo shëndetit publik. Një pezullim i tillë dhe rifillimi i zbatimit të Marrëveshjes i njoftohen menjëherë Palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet miqësisht nëpërmjet konsultimeve ose bisedimeve midis Palëve.

Neni 9
Ndryshimet

Çdo Palë mund të kërkojë me shkrim një ndryshim të të gjithë ose një pjese të kësaj Marrëveshjeje. Miratimi i ndryshimit do të bëhet me marrëveshje të ndërsjellë midis Palëve dhe do të hyjë në fuqi siç parashikohet në Nenin 10 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10
Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim në të cilin Palët njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike se janë përmbushur të gjitha kërkesat për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje siç përcaktohet në legjislacionin kombëtar.

2. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar, përveç nëse secila Palë vendos të përfundojë këtë Marrëveshje me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike 90 (nëntëdhjetë) ditë para datës së përfundimit të parashikuar të njoftimit.

Në dëshmi të sa më sipër, të nënshkruarit më poshtë kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Nju-Jork, në datën 25 shtator të vitit dymijë e tetëmbëdhjetë, në tri kopje, në gjuhët spanjisht, shqip dhe anglisht, ku secili nga tekstet është njëlloj autentik. Në rast divergjencash në interpretim dhe aplikim, teksti në gjuhën angleze ka përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Ditmir Bushati
Ministër për Evropën dhe ministër i Punëve të Jashtme

PËR QEVERINË E TË REPUBLIKËS SË SALVADORIT
Carlos Alfredo Castaneda Magaña
Ministër i Punëve të Jashtme

AGREEMENT
BETWEEN
THE COUNCIL OF MINISTERS OF THE REPUBLIC OF ALBANIA
AND
THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OFEL SALVADOR
VISA WAIVER PASSPORTS FOR HOLDERS OF DIPLOMATIC, OFFICIAL, SERVICE AND ORDINARY

The Council of Ministers of the Republic of Albania and the Government of the Republic of El Salvador hereinafter referred to individually as the "Party" and collectively as the "Parties".

RECOGNIZING existing friendly relations between the two countries.

DESIRING to simplify procedures related to visits by nationals of both countries, holders of diplomatic, official service and ordinary, the Republic of Albania and the Republic of El Salvador.

In accordance with the laws and regulations of the respective countries.

They have agreed as follows:

ARTICLE 1
VISA WAIVER

Nationals of either Party, who hold diplomatic, official and service passports valid, shall be exempt from the obligation to obtain a visa to enter, remain and leave the territory of the other Party, for a period not exceed 90 (ninety) days within 180 (one hundred and eighty days) from the date of entry, extendable in accordance with the respective laws, which may not engage in any work activity in the territory of the other party without prior authorization from the competent authorities.

Nationals of either Party, who are holders of ordinary passports valid shall be exempt from the requirement to obtain a visa to enter, stay and leave the territory of the other Party for a period not to exceed thirty days (30) days within 180 (one hundred and eighty days) the date of entry, which may be extended in accordance with the respective laws, which may not engage in any labor activity in the territory of the other party without the prior authorization of the competent authorities.

ARTICLE 2
DURATION OF PASSPORT VALIDITY

The passports of nationals of either Party shall have at least six (6) months of validity, in order to be used to enter the territory of the other Party.

ARTICLE 3
INPUT CONTROL POSTS

Nationals of either Party, holders of diplomatic or service and / or official or ordinary passports, may enter, stay or leave through the territory of the other Party by any of the land, air and sea borders enabled, provided that they comply with the laws and regulations of the respective parties relating to the entry and stay of foreigners.

ARTICLE 4
VISA RESTRICTION

Holders of valid passport of either Party referred to in this Agreement may enter and leave the territory of the other Party by any frontier authorized for that purpose by the competent immigration authorities, without any restrictions except those provided for safety reasons, immigration control, customs, sanitary and other provisions.

ARTICLE 5
RIGHT TO REJECTION / REFUSAL

Either party reserves the right to refuse entry, shorten or terminate the duration of stay of nationals of the other party entitled to exemption and visa facilitation under this Agreement if it considers the person no desirable.

ARTICLE 6

SPECIMENS OF PASSPORT

The Parties shall exchange, through diplomatic channels, specimens of their passports being used by each Party thirty (30) days before the entry into force of this Agreement, as well as specimens of the new passports before their introduction.

ARTICLE 7
SUSPENSION

Any Party may at any time temporarily suspend all or part of this Agreement reason of national security, public order or public health. Such suspension and the resumption of the application of the Agreement shall be notified immediately to the other party through the diplomatic channel.

ARTICLE 8
DISPUTE SETTLEMENT

Any dispute between the Parties concerning the interpretation or application of this Agreement shall be settled amicably through consultation or negotiation between the Parties.

ARTICLE 9
AMENDMENT

Any Party may request in writing an amendment of all or part of this Agreement. The approbation of the amendment will be made by mutual agreement between the Parties and enter into force as stated in Article 10 of this Agreement.

ARTICLE 10
ENTRY INTO FORCE, DURATION AND TERMINATION

1. This Agreement shall enter into force 30 (thirty) days after the date of receipt of the last written notification in which the Parties notify each other through diplomatic channels that all requirements for the entry into force of this Agreement have been fulfilled as stipulated in national legislation.

2. This Agreement shall remain in force for an indefinite period, unless either party decides to terminate this Agreement by written notice to the

other Party through diplomatic channels ninety 90 (days)before the date notification provided end.

IN WITNESS WHEREOF, the undersigned below have signed this Agreement.

Done at New York the 25 September day in the year two thousand and eighteen, in three copies, in Spanish, Albanian and English languages, each texts being equally authentic. In the case of divergence of interpretation and application, the English version shall prevail.

FOR THE COUNCIL OF MINISTERS OF THE REPUBLIC OF ALBANIA

DITMIR BUSHATI
MINISTER FOR EUROPE AND FOREIGN AFFAIRS

FOR THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF EL SALVADOR

CARLOS ALFREDO CASTANEDA MAGAÑA
MINISTER OF FOREIGN AFFAIRS

other Party through diplomatic channels ninety 90 (days)before the date notification provided end.

IN WITNESS WHEREOF, the undersigned below have signed this Agreement.

Done at New York the 25 September day in the year two thousand and eighteen, in three copies, in Spanish, Albanian and English languages, each texts being equally authentic. In the case of divergence of interpretation and application, the English version shall prevail.

FOR THE COUNCIL OF MINISTERS OF THE REPUBLIC OF ALBANIA

DITMIR BUSHATI
MINISTER FOR EUROPE AND FOREIGN AFFAIRS

FOR THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF EL SALVADOR

CARLOS ALFREDO CASTANEDA MAGAÑA
MINISTER OF FOREIGN AFFAIRS

VENDIM
Nr. 30, datë 23.1.2019

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ASFALTIM I RRUGËS 'KODËRMALEKAJ', BASHKIA LEZHË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Asfaltim i rrugës 'Kodërmalekaj', Bashkia Lezhë".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Lezhë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë "truall" + "ndërtesë", me vlerë të përgjithshme prej 5 844 588 (pesë milionë e tetëqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 5 844 588 (pesë milionë e tetëqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Lezhë, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Lezhë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë Bashkisë Lezhë.

8. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë Lezhë, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Lezhë.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lista e pronave dhe e pronarëve që do të shpronësohen për realizimin e projektit: "Asfaltim i rrugës 'Kodërmalekaj', Bashkia Lezhë"

	Pronari			Z.K.	Nr. pasurie	Tokë truall			
Nr.	**Emri**	**Atësia**	**Mbiemri**			**Sip. m^2**	**Çmimi lekë/m^2**	**Vlera lekë**	**Dokumenti i pronësisë**
1	Fred	Mark	Ndoka	8632	12/233/A	7	8511	59577	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Gjovalin	Dode	Beqiri	8632	10/123-A	96.4	8511	820460	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Aleksander	Nikoll	Uku	8632	10/124-A	117	8511	995787	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Kol	Gjon	Prenga	8632	10/145	13.6	8511	115750	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Lodovik	Filip	Ndrema	8632	10/172/A	25	8511	212775	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	Ilirjan	Fran	Lleshi	8632	10/335	9	8511	76599	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	Fran	Zef	Lleshi	8632	10/334	15	8511	127665	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	Zef	Pal	Hila	8632	12/,72	58	8511	493638	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Ardian	Fran	Biba	8632	10/226	14	8511	119154	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	Pjeter	Marash	Nika	8632	12/324	11	8511	93621	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	Ylli	Nikoll	Uku	8632	10/125	14.5	8511	123409	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
12	Mark	Preng	Nikolli	8632	12/113	28	8511	238308	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
13	Vladimir	Llesh	Brunga	8632	11/121	16	8511	136176	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
50	Ndryshim kufiri	32	22,400	14	9,800	19	13,067	57	39,993
51	Saktësim i kufijve te pasurisë	5,173	12,932,500	3,876	9,690,000	5,168	12,920,000	5456	13,640,500
	Rivlerësimi i pasurive(rvp)	41,679	29,175,300	7	4,900		0		0
		1,089,290	**1,641,042,600**	**724,117**	**1,100,124,800**	**965,480**	**1,466,826,533**	**971,107**	**1,500,957,593**
	Kamatvonesa		101,496,401		71,242,839		94,990,452		103,802,310
	Pjesëmarrje ne taksen e kalimit të pronësisë 3%		16,907,883		14,665,173		19,553,564		18,052,056
	Të ardhura nga noterët		15,305,804		7,846,400		10,461,867		13,662,696
	Të ardhura nga interesat bankare		1,130,798		805,745		1,074,327		1,201,656
	Të tjera		2,979,202		3,446,424		4,595,232		2,323,689
	Të ardhura tek llogaria e tatimeve						0		
		1,089,290	**1,778,862,688**	**724,117**	**1,198,131,382**	**965,480**	**1,597,501,976**	**971,107**	**1,640,000,000**

Shtojca nr. 3: Numri i shërbimeve dhe krijimi i të ardhurave për periudhën 2019-2021 (parashikimi)

Në 000 lekë

Nr	Lloji i shërbimit	2020		2021	
		Sasi	Vlerë	Sasi	Vlerë
1	Regjistrimi i akteve noteriale që lidhen ndërmjet zhvilluesit të pronës dhe pronarëve të truallit apo me subjektet e treta.	1,949	6,823,222	1,988	6,959,686
2	Regjistrimi i kalimit të pronësisë me anë të ligjit, me vendim të gjykatës, apo të një akti administrativ.	13,709	47,980,324	13,983	48,939,930
3	Regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të fituar me parashkrim fitues.	30	104,958	31	107,057
4	Regjistrimi i aktit për kalimin e pronësisë nga përmbaruesi gjyqësor.	786	2,749,376	801	2,804,364
5	Regjistrimi i akteve me të cilat krijohet një shoqëri apo një subjekt tjetër i së drejtës, që ka në pronësi pasuri të paluajtshme apo gëzon të drejta të tjera reale.	120	418,404	122	426,772
6	Regjistrimi i kontratave të shitjes.	27,324	95,633,909	27,870	97,546,587
7	Regjistrimi i kontratës së dhurimit	8,998	31,491,901	9,178	32,121,739
8	Regjistrim i deklarates për heqje dore nga pronësia	3,198	2,558,174	3,262	2,609,338
9	Regjistrimi i kontratës së shkëmbimit.	5,034	17,618,664	5,135	17,971,037
10	Regjistrimi i kontratës së qirasë apo të nënqirasë	1,127	3,944,850	1,150	4,023,747
11	Regjistrimi i titujve "në përdorim".	413	1,444,660	421	1,473,553
12	Regjistrim i aktit të trashegimis	30,785	21,549,186	31,400	21,980,170
13	Kopje të vertetuara të dokumentave tekniko-ligjore, në të cilat bazohet regjistri i pasurive të paluajtshme / faqe	38,605	7,720,978	39,377	7,875,398
14	Konsultim I karteles së pasurisë	1,181	826,526	1,204	843,057
15	verifikimi on-line i gjendjes juridike të pronesise në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme	876	525,790	894	536,305
16	Informacion zyrtar i pasurisë për individët dhe Institucionet	32,571	22,799,972	33,223	23,255,971
17	Lëshim kopje te fragmentit të hartës kadastrale	208,099	208,098,828	212,261	212,260,804
18	Lëshim kopje kartele te pasurise	244,038	244,037,538	248,918	248,918,289
19	Leshim vertetimesh (negativ/pozitiv)	38,203	11,461,026	38,967	11,690,247
20	Dhënie e informacionit koordinativ për cdo pasuri të paluajtshme.	54	53,856	55	54,933
21	Lëshim certifikate pronësise	172,309	258,464,022	175,756	263,633,302
22	Leshim vertetim pronësie	17,096	25,643,820	17,438	26,156,696
23	Lëshimi i një certifikate të re kur ka humbur apo është dëmtuar certifikata e marrë.	2,691	2,153,043	2,745	2,196,104
24	Regjistrim i vendimit gjyqësor për vendosjen e mases së sigurimit të padisë	110	98,777	112	100,752
25	Regjistrim i kërkes padise	289	260,161	295	265,364
26	Regjistrim i aktit noterial për pezullimin e veprimeve të regjistrimit	117	105,692	120	107,806
27	Regjistrim /ndryshim/ shuarje Servituti	757	681,156	772	694,779
28	Regjistrim i kontratës së shitjes, kontratës së shkëmbimit dhe kontratës së dhurimit me rezerve/kusht të pasurisë së paluajtshme	2,006	1,805,522	2,046	1,841,633
29	Regjistrim i të drejtes së parablerjes	39	34,945	40	35,644
30	Regjistrim i prokurës	1,871	1,683,979	1,909	1,717,659
31	Korrigjim gabimesh në kartele	19,354	13,547,531	19,741	13,818,482
32	Korrigjim gabimesh në hartën kadastrale	3,254	2,278,041	3,319	2,323,602
33	Korrigjim gabimesh në certifikatën e pasurisë së paluajtshme	836	585,099	853	596,801
34	Kërkese për regjistrimin e bashkimit, ndarjes apo pjestimit të pasurise së paluajtshme	37,181	26,026,871	37,925	26,547,408
35	Regjistrimi i kontratës së hipotekes për garantimin e kredise së dhënë nga banka apo institucion tjeter kredidhënës, për kredi me vlerë deri në 1.000.000 leke	1,187	8,900,714	1,210	9,078,728
36	Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjeter kredidhënës, për kredi me vlerë1 000.000 - 10 000 000 leke	6,170	92,552,815	6,294	94,403,871
37	Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës, për kredi me vlerë mbi 10 000 000 leke	4,416	110,389,373	4,504	112,597,160
38	Regjistrim apo fshirje e kontrave të tjera të hipotekës	11,448	11,447,596	11,677	11,676,548
39	Regjistrim apo fshirje e hipotekës ligjore	3,824	3,824,490	3,901	3,900,979
40	Regjistrimi i Aktit të Bashkëpronësisë për objektet në bashkëpronësi të detyrueshme	33	165,580	34	168,892
41	Regjistrimi i objekteve të legalizuara	19,181	95,905,160	19,565	97,823,263
42	Regjistrim fillestar i pasurisë së paluajtshme pa rilevim e azhornim nga ZRPP	3,999	19,995,060	4,079	20,394,961
43	Regjistrim fillestar i pasurisë së paluajtshme me rilevim e azhornim nga ZRPP	98	780,640	100	796,253
44	Regjistrim fillestar i vecantë i pasurive të paluajtshme në zonat rurale	102	3,060,000	104	3,121,200
45	Kalim i regjistrimit nga regjistrat hipotekore në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, para ose pas përfundimit të regjistrimit fillestar.	2,557	2,557,004	2,608	2,608,144
46	Regjistrimi lejes së ndertimit	590	590,444	602	602,253
47	Regjistrimi i përkohshem I karabinase	96	626,756	98	639,291
48	Regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja.	16,132	104,855,218	16,454	106,952,322
49	Regjistrimi i marrëveshjeve dhe akteve lidhur me kufijte e pasurive te paluajtshme	64	160,990	66	164,210
50	Ndryshim kufiri	58	40,793	59	41,609
51	Saktësim i kufijve te pasurisë	5,565	13,913,310	5,677	14,191,576
	Rivleresimi I pasurive(rvp)		0		0
		990,529	**1,530,976,745**	**1,010,340**	**1,561,596,280**
	Kamatvonesa		102,764,287		101,736,644
	Pjesemarrje ne taksen e kalimit te pronesise 3%		18,413,097		18,781,359
	Te ardhura nga noteret		13,935,950		14,214,669
	Te ardhura nga interesat bankare		1,225,689		1,250,203
	Te tjera		2,370,163		2,417,566
	Te ardhura tek llogaria e tatimeve				
		990,529	**1,669,685,931**	**1,010,340**	**1,699,996,721**

PARASHIKIMI I VLERËS QË DO TË TRASHËGOHET NË VITIN 2019

Në 000/ lekë

Të ardhurat dhe shpenzimet e pritshme Janar - Dhjetor 2018	Të Ardhura	Shpenzime	
Përshkrimi	(1)	(2)	
Të ardhura e pritshme janar-dhjetor 2018	1,597,502		2,754,859
Të ardhura të trashëguara nga 2017	1,052,657		
Fondi rezervë i trashëguar	104,700	104,700	
Shpenzime për paga të pritshme janar-dhjetor 2018		547,383	I pritshmi
Fondi i veçantë i pritshëm		1,557	I pritshmi
Shpenzimet për sigurime të pritshme janar-dhjetor 2018		95,048	I pritshmi
Shpenzimet operative të pritshme janar-dhjetor 2018		265,593	I pritshmi
Investime 230 të pritshme janar-dhjetor 2018		455,185	I pritshmi
Investime 231 të pritshme janar-dhjetor 2018		137,934	Plani vjetor
Totali	**2,754,859**	**1,607,399**	
Teprica (1)-(2)		**1,147,459**	

Në 000/lekë

Nr.	EMËRTIMI	BUXHETI 2018	I Pritshmi 2018	Vlera e parashikuar për t'u trashëguar nga 2018
1	Të ardhura nga tarifat e shërbimeve	1,634,458	1,597,502	-36,956
2	Fonde që parashikohet të trashëgohen nga viti 2016	1,052,657	1,052,657	0
3	Fond rezerve i trashëguar	104,700	104,700	0
4	Paga	710,801	547,383	163,418
5	Kontribute për sigurime shoqërore	117,990	95,048	22,942
6	Fondi i veçante i pagave	29,963	1,557	28,406
7	Shpenzime të mirëmbajtjes e të tjera	308,333	265,593	42,740
8	Shpenzime të planifikuara për gjyqin e arbitrazhit	150,000	0	150,000
9	Fond i ngrirë	483,718	0	483,718
10	Investime kapitale të brendshme 230	175,252	0	175,252
11	Projekti (230)	572,285	455,185	117,100
12	Investime kapitale të brendshme 231	138774	137,934	840
13	Fondi Rezervë	104,700	104700	0
	TË ARDHURA (-) SHPENZIME	**150,000**	**1,147,459**	**1,147,459**

Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore të parashikuara për periudhën janar–dhjetor 2019
Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Nr.	Pozicioni	Nr. i punonjësve	Kategoria/ klasa	Paga mujore e grupit/ klasës	Vjet. mes (në vite)	Vjet. mujore në lekë	Shtesa mujore për pozicion	Shtesa mujore për kushte pune	Paga mujore bruto	Fondi i pagave (në 000/lekë)	Fond page mbi të cilin	Sig. shoqërore		Sig. shoqërore
Nr.	Pozicioni	Nr. i punonjësve	Kategoria/ klasa	Paga mujore e grupit/ klasës	Vjet. mes (në vite)	Vjet. mujore në lekë	Shtesa mujore për pozicion	Shtesa mujore për kushte pune	Paga mujore bruto	Fondi i pagave (në 000/lekë)	Fond page mbi të cilin llogariten sig. shoqërore	Sig. shoqërore	Sig. shëndetësore	
									7=3+4+5+6	8=7*1*12m	kufiri max 105850 lekë	9*15%	8*1.7%	Paga + sig. shoq.
		1	2	3	4		5	6		8	9	10		11=8+10
	Punonjës me sistemin page grupi + shtesë për pozicion													
1	Kryeregjistrues L 1/1	1	IIa	14,000	11	3,080	118,100	20,000	155,180	1,862	1,270	191	32	2,084
2	Zv/kryeregjistrues	2	IIb	14,000	15	4,200	100,000	17,500	135,700	3,257	2,540	381	55	3,693
3	Drejtor drejtorie	6	III- a	14,000	15	4,200	80,800	17,000	116,000	8,352	7,621	1,143	142	9,637
4	Drejtor drejtorie IT	1	III- a	14,000	15	4,200	80,800	25,000	124,000	1,488	1,270	191	25	1,704
5	Përgjegjës Sektori	13	III-a/1	14,000	10	2,800	70,500	12,000	99,300	15,491	15,491	2,324	263	18,078
6	Përgjegjës sektori	1	III-b	14,000	10	2,800	61,000	7,000	84,800	1,018	1,018	153	17	1,188
7	Përgjegjës sektori IT për ALBSReP	5	III-a/1	14,000	10	2,800	70,500	25,000	112,300	6,738	6,351	953	115	7,805
8	Përgjegjës sektori programues	1	III-a/1	14,000	10	2,800	70,500	40,000	127,300	1,528	1,270	191	26	1,744
10	Auditues të brendshëm	4	III-b	14,000	15	4,200	61,000	7,000	86,200	4,138	4,138	621	70	4,829
11	Specialist	50	IV-a	14,000	5	1,400	49,000	12,000	76,400	45,840	45,840	6,876	779	53,495
12	Specialist IT programues	8	IV-a	14,000	5	1,400	49,000	40,000	104,400	10,022	10,162	1,524	170	11,717
13	Specialist IT	15	IV-a	14,000	5	1,400	49,000	25,000	89,400	16,092	16,092	2,414	274	18,779
	ZRPP NIVELI I PARË								0	0				
1	Regjistrues ZVRPP Tirane	1	III-a	14,000	20	5,600	80,800	16,500	116,900	1,403	1,270	191	24	1,617
2	Regjistrues	14	III-a/1	14,000	20	5,600	70,500	16,500	106,600	17,909	17,783	2,667	304	20,881
3	Zv/Regjistrues (Niv I)	12	III-b	14,000	15	4,200	61,000	16,500	95,700	13,781	13,781	2,067	234	16,082
4	Pergj Sekt (niv I)	57	IV-a	14,000	22	6,160	49,000	12,000	81,160	55,513	55,513	8,327	944	64,784
5	Specialist	353	IV-b	14,000	12	3,360	38,000	12,000	67,360	285,337	285,337	42,801	4,851	332,988
6	Specialist IT	29	IV-b	14,000	12	3,360	38,000	15,000	70,360	24,485	24,485	3,673	416	28,574
	ZRPP NIVELI I DYTË								0	0				
1	Regjistrues	20	III-b	14,000	20	5,600	61,000	16,500	97,100	23,304	23,304	3,496	396	27,196
2	Përgj. sekt (niv II)	7	IV-b	14,000	22	6,160	38,000	12,000	70,160	5,893	5,893	884	100	6,878
3	Specialist	69	IV-c	14,000	12	3,360	29,500	8,000	54,860	45,424	45,424	6,814	772	53,010
	Punonjës të sistemit me klasa				1				0	0				
1	Shofere	4	IV	33,400	16	5,344			38,744	1,860	1,860	279	32	2,170
3	Mirëmbajtës	1	IV	33,400	17	5,678		5,340	44,418	533	533	80	9	622
4	Magazinier	1	VI	35,250	25	8,813		5,340	49,403	593	593	89	10	692
5	Pastruese	2	I	30,000	25	7,500		5,340	42,840	1,028	1,028	154	17	1,200
	ZRPP NIVELI I PARË								0	0		0	0	0
1	Sekretare lidhja II/I	1	IX	36,000	7	2,520			38,520	462	462	69	8	539
2	Teknik mirëmbajtës dokumentacioni librash	1	IX	36,000	12	4,320		10,000	50,320	604	604	91	10	705
3	Punëtor mirëmbajtës	1	IV	33,400	25	8,350		5,340	47,090	565	565	85	10	659
4	Pastruese	8	I	30,000	25	7,500		5,340	42,840	4,113	4,113	617	70	4,799
	Totali paga janar–dhjetor 2019	**688**							**2,425,355**	**598,632**	**595,611**	**89,342**	**10,177**	**698,151**
Fond i veçantë deri në 5% të fondit të pagave										**29,932**				**29,932**
	Totali									**628,564**	**595,611**	**89,342**	**10,177**	**728,082**
Punonjës me kontrate të përkohshme (100 punonjës)										139,908	139,908	20,986	2,378	163,273
TOTAL PAGA + SIG për vitin 2019										**768,472**	**735,519**	**110,328**	**12,555**	**891,355**

Përmbledhje e shpenzimeve të personelit, për punonjësit me kontratë 1-vjeçare për vitin 2019

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

000/leke

Nr.	*Pozicioni*	*Nr. i punonjësve*	*Kategoria/ klasa*	*Paga mujore e grupit/klasës*	*Vjet. mes (në vite)*	*Vjet. mujore në lekë*	*Shtesa mujore për pozicion*	*Shtesa mujore për kushte pune*	*Paga mujore bruto*	*Fondi i pagave (në 000/lekë)*	*Fond page mbi të cilin*	*Sig. shoqërore*		*Sig. shoqërore*
Nr.	*Pozicioni*	*Nr. i punonjësve*	*Kategoria/ klasa*	*Paga mujore e grupit/klasës*	*Vjet. mes (në vite)*	*Vjet. mujore në lekë*	*Shtesa mujore për pozicion*	*Shtesa mujore për kushte pune*	*Paga mujore bruto*	*Fondi i pagave (në 000/lekë)*	*Fond page mbi të cilin llogariten sig. shoqërore*	*Sig. shoqërore*	*Sig. shëndetësore*	*Paga + sig. shoq.*
									7=3+4+5+6	***8=7*1*12***	***kufiri max 105850lekë***	***9*15%***	***8*1.7%***	
		1	*2*	*3*	*4*		*5*	*6*		*8*	*9*	*10*		*11=8+10*
	Punonjës me sistemin page grupi + shtesë për pozicion													
1	Specialist (janar–dhjetor 2019)	160	IV-b	14,000	6	1,680	38,000	12,000	65,680.0	126,106	126,106	18,916	2,144	147,165
2	Specialist (janar–dhjetor 2019)	15	IV-a	14,000	6	1,680	49,000	12,000	76,680.0	13,802	13,802	2,070	235	16,107
	Totali paga janar–dhjetor 2019									**139,908**	**139,908**	**20,986**	**2,378**	**163,273**

Shpenzimet operative të ZRPP-së për 2019-n

Artikulli	*Përshkrimi*	Plani 2019 në 000/lekë
602.0	Materiale zyre dhe të përgjithshme	57,019
602.1	Materiale dhe shërbime speciale	8,627
602.2	Shërbime nga të tretë	170,417
602.3	Shpenzime transporti	7,569
602.4	Shpenzime udhëtimi	15,982
602.5	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	17,122
602.6	Shpenzime për qiramarrje	3,633
602.7	Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale	184,980
602.9	Shpenzime të tjera operative	14,975
Totali		**480,325**

Kërkesat për investime 2019 ZQRPP + ZVRPP

Në 000/lekë

Nr.	ZVRPP	Rikonstruksion	Pajisje zyrë fotokopje, skaner, printer	Orendi	Kondicioner	MKZ	Sistem sigurie kamera	Gjenerator	Sistem check-in hyrje–dalje	Shuma
1	**BERAT**	7,451								**7,451**
2	**BULQIZË**									**0**
3	**DEVOLL**	200				150	100			**450**
4	**DIBËR**									**0**
5	**DURRËS**						1,200			**1,200**
6	**ELBASAN**									**0**
7	**FIER**	2,500				1,500				**4,000**
8	**GRAMSH**									**0**
9	**GJIROKASTËR**			200	400					**600**
10	**HAS**	400								**400**
11	**KAVAJË**					50				**50**
12	**KOLONJË**	500								**500**
13	**KORÇË**									**0**
14	**KRUJË**			300	200					**500**
15	**KUÇOVË**									**0**
16	**KUKËS**	2,000								**2,000**
17	**LAÇ**	972								**972**
18	**LEZHE**									**0**
19	**LIBRAZHD**							600		**600**
20	**LUSHNJË**				450					**450**
21	**M. MADHE**	301								**301**
22	**MALLAKASTËR**									**0**
23	**MAT**									**0**
24	**MIRDITË**			50	120	97	150			**417**
25	**PEQIN**	1,811					700			**2,511**
26	**PËRMET**	790				700				**1,490**
27	**POGRADEC**									**0**
28	**PUKË**									**0**
29	**SARANDË**									**0**
30	**SKRAPAR**	1,994		250			300			**2,544**
31	**SHKODËR**			500						**500**
32	**TEPELENË**				550					**550**
33	**TIRANË**									**0**
34	**TROPOJË**	100								**100**
35	**VLORË**				1,200					**1,200**
36	**Z. QENDRORE**		88,927	800	800	800	800		300	**92,427**
	TOTALI	**19,019**	**88,927**	**2,100**	**3,720**	**3,297**	**3,250**	**600**	**300**	**121,213**

Investime IT: Projekte

Nr.	Titulli	Studimi i tregut pa TVSH	TVSH	Vlera në lekë me TVSH	Vlera në /000 lekë me TVSH
1	Përmirësimi i arkivit digjital	91,666,667	18,333,333	110,000,000	110,000
2	E-billing	105,833,333	21,166,667	127,000,000	127,000
3	Pen Test	66,666,667	13,333,333	80,000,000	80,000
4	Incidentet kibernetike	95,000,000	19,000,000	114,000,000	114,000
	TOTALI			**431,000,000**	**431,000**

Investime IT: Pajisje dhe programe e licenca

Nr.	Titulli	Përshkrimi	Prioriteti	Studimi i tregut pa TVSH	TVSH	Vlera me TVSH	Vlera në 000 lekë	Komente	Referenca
1	Programe dhe licenca	ZQRPP	10	42,802,948	8,560,590	51,363,538	51,363.54	Referuar vlerës së tregut në Internet	
2	Pajisje: storage, serverë aplikacionesh, Backup Solution, Routers dhe Switches + instalim dhe konfigurim	ZQRPP	10	12,606,040	2,521,208	15,127,248	15,127.25	Shënim: Nuk është përfshirë çmimin për Backup Solution hw&sw për mungesë oferte	
3	Pc Desktop Tipi 2	Zyrat Vendore dhe Zyra Qendrore	10	12,000,000	2,400,000	14,400,000	14,400.00	http://akshi.gov.al/standarde-tik/specifikime-teknike/	100 kompjuterë + 5 laptopë
4	Skaner Flatbed dhe ADF Tipi 5	Zyrat Vendore dhe Zyra Qendrore	8	5,000,000	1,000,000	6,000,000	6,000.00	http://akshi.gov.al/standarde-tik/specifikime-teknike/	Pajisje HW të nevojshme për shtrirjen e sistemit fast-track në ZVRPP
5	Fotokopje bardh/zi Multifunction High Volume Copy Machine	Zyrat Vendore dhe Zyra Qendrore	10	42,000,000	8,400,000	50,400,000	50,400.00	http://akshi.gov.al/standarde-tik/specifikime-teknike/	70 njësi të cilat do të shpërndahen në të gjitha ZVRPP-të në kuadër të rinovimit të infrastrukturës fizike mbështetëse
6	UPS 600VA		10	2,500,000	500,000	3,000,000	3,000.00	Referuar vlerës mesatare të ofertave të kaluara	
	TOTALI					**140,290,786**	**140,291**		

Shpenzime IT 2019

Nr.	Titulli	Përshkrimi	Prioriteti	Studimi i tregut pa TVSH	TVSH	Vlera me TVSH	Komente	Referenca
1	Konektiviteti për ALBSReP + ALBPOS	35 zyra + Albpos	10	48,400,000	9,680,000	58,080,000	Referuar vlerës mesatare të ofertave të kaluara	Kontratë shërbimi 2-vjeçare referuar LPP nr. 9643 (me vlerë për 2 vjet 116160000 lekë)
2	Mirëmbajtja e fotokopjeve, printerëve, skanerëve në ZQRPP	ZQRPP	8	800,000	160,000	960,000	Nuk ka oferte nga tregu. Vlerësimi është paraprak, nisur nga kostot e pajisjeve.	
3	Mirëmbajtja e gjeneratorit të energjisë elektrike dhe riparime elektrike të rrjetit	ZQRPP	8	400,000	80,000	480,000	Referuar ofertës së marrë më parë nga ABiEsse	
4	Mirëmbajtja periodike e UPS të sallës së serverëve	ZQRPP	8	90,000	18,000	108,000	Nga ABiEsse nuk përfshihen riparimet dhe materialet	
5	Trajnime	ZQRPP	8	2,296,700	459,340	2,756,040	Nuk ka oferta në treg	
6	Mirëmbajtje e Sistemit Multifunksional për shërbimet që ofrohen në ZRPP	ZQRPP		2,400,000	480,000	2,880,000	Sipas kontratave të lidhura në vitin 2016	
7	Mirëmbajtja e Platformës së Ndërveprimit në lidhje me 51 shërbimet sipas marrëveshjes me AKSHI-n	ZQRPP		790,000	158,000	948,000	Sipas kontratave të lidhura në vitin 2016	
8	Mirëmbajtje e Modulit të Përmirësimit të Nideve	ZQRPP		400000	80,000	480,000	Sipas kontratave të lidhura në vitin 2016	
9	Materiale mbështetese	ZQRPP	7	1,601,127	320,225	1,921,352	Referuar çmimeve të tregut në vend	
	TOTALI			**57,177,827**	**11,435,565**	**68,613,392**		

PROJEKTI I PËRMIRËSIM / PËRDITËSIMIT DHE REGJISTRIMIT FILLESTAR TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PËR VITIN 2019

Buxheti për Projektin e Përmirësim Përditësimit dhe Regjistrimit fillestar është si më poshtë:

				Në lekë	*Në 000/lekë*
I	**Personeli - pagat**	**Kategoria**	**Paga bruto**	**410,682,116**	**410,682**
1	Drejtori i projektit	IIIA	1	1,604,858	1,605
2	përgjegjës sektori	IIIA-1	12	16,687,166	16,687
3	Specialist i Sek. të Skanimit dhe Afishimit Publik	IV-A	29	31,027,262	31,027
4	Specialist i Sek. të Përmirësimit Digjital të Kartelës	IV-A	103	110,200,277	110,200
5	Specialist i Sek. të Përmirësimit Digjital të Hartës	IV-A	82	87,732,259	87,732
6	Specialist i Sek. të PP dhe Finalizimit të Produktit	IV-A	82	87,732,259	87,732
7	Specialist i Sek. të RF. Jurist/Hartograf.	IV-A	40	42,796,224	42,796
8	Specialist i Sek. Teknologjisë së Informacionit	IV-A	10	10,699,056	10,699
9	Specialiste / ZQRPP	IV-A	18	19,258,301	19,258
10	Sanitare	I	2	1,199,863	1,200
11	Shofer	IV	2	1,122,561	1,123
12	Punëtorë mirëmbajtje	IV	1	622,030	622
II	**Ambientet me qira**	**njësia**	**çmimi/m2**	**4,523,969**	**4,524**
1	Salla 1	235,7m2	12 euro	4,523,969	4,524
III	**Shpenzime të përgjithshme**	**në muaj**	**viti**	**8,012,631**	**8,013**
3	Shpenzime të përgjithshme			8,012,631	8,013
IV	**Afishimi publik**	**ZK**	**Cope total**	**20,720,000**	**20,720**
1	Ambienti me qira	180	180	9,000,000	9,000
2	Posterë	180	3600	720,000	720
3	Fletëpalosje	180	180000	2,700,000	2,700
4	Njoftim gazete	180	540	8,100,000	8,100
5	Materiale të tjera	1	1	200,000	200
V	**Printim dhe lidhje kartelash**	**140,000 pasuri**	**32 leke/pasuri**	**4,480,000**	**4,480**
VI	**Orendi**	**copë**	**çmim/njesi**	**885,000**	**885**
9	Kondicioner	3	80000	240,000	240
10	Dollapë	3	25000	75,000	75
11	Karrige	50	11400	570,000	570
VII	**Udhëtime/dieta**	1 vit	**5,550,000**	**5,550,000**	**5,550**
VIII	**Karburant**	1 vit	**4942080**	**4,942,080**	**4,942**
			TOTALI	**459,795,797**	**459,796**

INVESTIMET PËR VITIN 2019

Në 000/lekë

Artikulli	Shpenzime kapitale	Vlera
231	Rikonstruksion i ZVRPP	19,019
231	Pajisje për ZQRPP dhe ZVRPP	88,927
231	Orendi për zyrat vendore	2,100
231	Kondicioner për zyrat vendore	3,720
231	Sistem i Mbrojtjes kundër Zjarrit (MKZ) për ZVRPP	3,297
231	Sistem sigurie kamera për ZVRPP	3,250
231	Gjenerator për ZVRPP	600
231	Sistem check-in hyrje–dalje për ZQRPP	300
	Shuma 231	**121,213**
230	E-billing	127,000
230	Penetration Test	80,000
230	Incidentet kibernetike	114,000
230	Përmirësimi i arkivit digjital	110,000
230	Programe dhe licenca	51,364
230	Projekti i përmirësim / përditësimit dhe regjistrimit fillestar	459,796
	Shuma 230	**942,159**
	Investime gjithsej (230+231)	**1,063,373**

VENDIM
Nr. 36, datë 23.1.2019

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR BASHKËPUNIMIN, NXITJEN E BIZNESIT DHE INFORMIMIN E DIASPORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin, nxitjen e biznesit dhe informimin e diasporës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR BASHKËPUNIMIN, NXITJEN E BIZNESIT DHE INFORMIMIN E DIASPORËS

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (këtej e tutje referuar si "Palët") me dëshirën që të bashkëpunojnë në kuadrin e funksioneve, qëllimeve dhe juridiksioneve të tyre;

Duke konsideruar se bashkëpunimi i tyre do të ndihmojë në realizimin e përgjegjësive edhe në funksion të "Marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushën e diasporës", nënshkruar në Korçë, më 27.11.2018; Kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1
Qëllimi

Kjo marrëveshje ka si qëllim bashkëpunimin, nxitjen e biznesit dhe informimin e diasporës.

Neni 2
Fushat e bashkëpunimit

1. Palët në bashkëpunim do të nxisin dhe ndihmojnë në krijimin e Këshillit të Bashkëpunimit të Diasporës Shqiptare, i cili do të kontribuojë në realizimin e organizimit më të mirë të komuniteteve shqiptare në vendet pritëse.

2. Palët do të nxisin dhe ndihmojnë krijimin e Dhomës (Odës) së biznesit të Diasporës në Tiranë dhe Prishtinë duke respektuar rregullat e funksionimit të të njëjtit rrjet biznesi në diasporë.

3. Palët do të nxisin fillimin e punës nga televizionet publike respektive Radio-Televizioni i Shqipërisë RTSH dhe Radio-Televizioni i Kosovës, që të realizohet një kanal i përbashkët televiziv kushtuar interesave të komuniteteve shqiptare në diasporë.

4. Palët do të angazhohen që brenda vitit 2019 stacioni televiziv i përbashkët të fillojë transmetimin e programeve të veçanta për mësimin e gjuhës dhe të programeve të miratuara nga ministritë përgjegjëse të arsimit, ministritë përgjegjëse të kulturës dhe ministritë përgjegjëse për diasporën shqiptare.

5. Palët bien dakord të ndihmojnë iniciativën e krijimit në Tiranë dhe Prishtinë të Bankës së Diasporës nga rrjetet e biznesit të komuniteteve shqiptare të diasporës shqiptare.

Neni 3
Format e bashkëpunimit

Palët do të shkëmbejnë informacionin dhe eksperiencën sipas legjislacioneve rregulluese respektive, për nxitjen e një bashkëpunimi efektiv dhe bien dakord të bashkëpunojnë në çështjet e mëposhtme:

1. Të krijojnë procedura koordinimi dhe informacioni, me anë të të cilave palët ndihmojnë njëra tjetrën për qëllimet e përbashkëta.

2. Të vlerësojnë një plan-veprimi të përbashkët për bashkëpunimin me strukturat organizative të diasporës në funksion të ndihmës efektive për interesat e komunitetit shqiptar në vendet pritëse.

3. Të organizojnë veprimtari të përbashkëta në funksion të qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje.

4. Të organizojë takime të rregullta midis Palëve për të diskutuar realizimin e kësaj Marrëveshje, për të shkëmbyer informacion dhe për të adresuar çështje specifike të rregullimit ose probleme që mund të kenë lindur.

5. Të sigurojnë dokumentet përkatëse, duke përfshirë si më poshtë:

Organigramat e Palëve me emrat e stafit përkatës dhe përgjegjësitë e tyre; dhe Listën e përfaqësuesve të autorizuar për të kryer aktivitet në funksion të kësaj Marrëveshje.

Neni 4
Ligji i zbatueshëm

Aktivitetet e kryera në pajtim me këtë Marrëveshje, në mënyrë të veçantë për ndarjen e informacionit dhe pjesëmarrjen në veprime të përbashkëta duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin rregullues të Palëve.

Neni 5
Gjuha

Gjuha zyrtare e kësaj Marrëveshje është gjuha shqipe. Shkëmbimet zyrtare të informatave dhe dokumenteve do të bëhen në gjuhën shqipe.

Neni 6
Ndryshimet

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet apo plotësohet vetëm me shkrim nëpërmjet negociatave dhe miratimit të ndërsjellë të Palëve. Ndryshimi do të hyjë në fuqi në datën kur njoftohet dhënia e pëlqimit nga pala tjetër.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje zgjidhet nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve.

Neni 8
Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim ku Palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përmbushjen e procedurave të tyre të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi.

2. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar. Secila palë mund të njoftojë palën tjetër me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e Marrëveshjes, Përfundimi do të ketë efekt gjashtë muaj pas marrjes së një njoftimi të tillë.

Bërë në Pejë, 2018, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, të dyja tekstet njëlloj të vlefshme.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:
KRYEMINISTRI
Edi Rama

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS:
KRYEMINISTRI
Ramush Haradinaj

VENDIM
Nr. 37, datë 23.1.2019

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Ilir Bejtja emërohet zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 38, datë 23.1.2019

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Enis Aliko, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë,

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 14, datë 22.01.2019

MBI FILLIMIN E PROCESIT TË KRIJIMIT TË SKEMËS SË DELEGIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i mbledhur në datën 22.1.2019, në përmbushje të përgjegjësive për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, në respektim të parimit qeverisës të eficiencës, në ushtrim të kompetencave në lidhje me administrimin e gjykatave, bazuar në nenin 147 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenet 2 dhe 89, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", në funksion të aplikimit të skemës së delegimit dhe asaj të transferimit të përkohshëm, sipas neneve 45 dhe 46, të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

VENDOSI:

1. Fillimin e procesit për krijimin e skemës së delegimit, si dhe, deri në zbatimin e saj, për transferimin e përkohshëm në çdo gjykatë ku evidentohet nevoja për krijimin e trupës gjyqësore në rastin konkret.

2. Të kërkohet pëlqimi i të gjithë magjistratëve në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit në Republikën e Shqipërisë, që pa lëvizur nga pozicioni ku është emëruar, për kandidimin në skemën e delegimit sipas nenit 45, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si edhe për dhënien e pëlqimit për transferimin e përkohshëm sipas nenit 46 të këtij ligji.

3. Dhënia e pëlqimit nga magjistratët të dokumentohet me një deklaratë me shkrim sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi, ku të evidentohet qartë pëlqimi i tij sa i përket kandidimit në skemën e delegimit dhe/ose për transferimin e përkohshëm.

4. Dhënia e pëlqimit me shkrim nga magjistratët të depozitohet, brenda datës 25.1.2019, pranë Kryetarit të Gjykatës ku magjistrati ushtron funksionin.

5. Kryetari i Gjykatës, brenda datës 26.1.2019, depoziton deklaratat për dhënien e pëlqimit të magjistratëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

6. Në mungesë të dhënies nga magjistratët të pëlqimit sipas nenit 45, 46 të ligjit, Këshilli i Lartë Gjyqësor do të fillojë procedurat sipas nenit 46, pika 2, të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", për përmbushjen e nevojave të gjykatave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

DEKLARATË
PËR KANDIDIM NË SKEMËN E DELEGIMIT

Unë _____, aktualisht gjyqtar/e pranë Gjykatës _____, me vullnetin tim të lirë, mbështetur në nenin 45, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", shpreh pëlqimin për kandidim në skemën e delegimit që do të krijohet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe për t'u caktuar në këtë mënyrë në çdo gjykatë ku evidentohet nevoja për krijimin/plotësimin e trupës gjyqësore në rastet konkrete.

DEKLARUESI
(_____)

DEKLARATË
PËR DHËNIE PËLQIMI PËR TRANSFERIM TË PËRKOHSHËM

Unë _____, aktualisht gjyqtar/e pranë Gjykatës _____, me vullnetin tim të lirë, mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", shpreh pëlqimin tim për transferimin e përkohshëm, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në çdo gjykatë ku evidentohet nevoja për krijimin/plotësimin e trupës gjyqësore në rastet konkrete.

DEKLARUESI
(_____)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 308 lekë